

## SHERBESA E HYMNIT AKATHIST

*Kjo Shërbesë mbahet të Prëmtën e Javës së Pestë të Kreshmëve mbrëmëne. Këndimet vazhdojnë si në Përshëndoshjet I gjer në funt të Simbolit të Besës. Pastaj pa zë:*

Ti me të vërtetë meriton, lavdërime ti o Virgjërshë: Ti je më e lumura, dhe më e ndriçimja, ti je Nën' e Zotit Jesu Krisht; ti je e nderuar mi Kerubim, dhe e lavdëruar pa përqsasje mi Serfim; ti me të vërtetë linde Fjalë Perëndinë. Pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjllindëse.

*Pastaj këndohet dy herë ngadale dhe një herë shkurtër:*

## PERLESHORJA, T. T. IV

## TO PROSTAKHTHEN MISTIKOS

Si mori vesh porrosin' e perëndishme, Engjëlli zbriti në banesën e Josefit, dhe ia pruri Marisë mënjëherë lajmën. E epi me bashkëzbritjen qjellin mi dhe, kur hyri i pandryshuar në gjirin tënt, dhe atë kur e shoh me sy, të mishëruar si rob, çuditem dhe të thërres me zë, Gëzohu nuse e panusëruar. (3 herë)

*Pastaj Prifti shkon përpara Korës së Shen Marisë, e temjanis tri herë, dhe këndon Stanzën e Parë të Përshëndoshjeve:*

## STANZA E PARE

PRIFTI: Engjëlli kryetar u-dërgua prej qjellit, që t'i thotë Virgjërshës: "Gëzohu!" Dhe kur të pa që u-mishërove bashkë me zërin ëngjëllor, çuditej dhe qëndronte, dyke i thirrur kështu:

Gëzohu ti, me anën e së cilës do të shkëlqenjë gazi; gëzohu ti, me anën e së cilës do të humbasë mallkimi.

Gëzohu, o ndjellje e Adamit të rënë; gëzohu, o çpërblim i loteve të Evës.

Gëzohu, o lartësirë ku mëndjet njerëzore nuk arrijnë dot; gëzohu, o thellësirë, ku sytë a Engjëjve nukë shikojnë dot.

Gëzohu, se je froni i Mbretit; gëzohu, se e mban atë, që i mban të gjitha.

Gëzohu, o yll, që siell diellin; gëzohu, o Nënë, që mishëron Perëndinë.

Gëzohu ti, me anën e së cilës përsëritet natyra; gëzohu ti, me anën e së cilës foshnjërohet Krijetari.

Gëzohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: Dyke parë veten të kulluar e Shënjta, i thotë me kuxim Gabrielit: Lajma jote e çudiçime më duket e pabesuarshme për shpirtin. Se qysh po flet për një foshnjëlindje të pafarëshme, dyke thirrur: Alilluia.

KORI: Alilluia.

PRIFTI: Dyke kërkuar të mësonjë dijë të paditur, Virgjërsha i thirri meshëtarit: "Si është e mundur që të lindë një bir prej një gjiri virgjëror? Thuaj-më." Dhe ay i tha me frikë, dyke thirrur kështu:

Gëzohu, o nisjatore e një këshille të fshehtë; gëzohu, o besë e atyre, që falen në heshtje.

Gëzohu, o parëthënje e çudive të Krishtit; gëzohu, o nisje e doktrinave të tij.

Gezohu, o shkallë qjellore, me të cilën zbriti Perëndia; gëzohu, o urë, që shpie prej dheut në qjell.

Gëzohu, o çudi e shumëfamëshme e Engjëjve; gëzohu, o plagë e shumëvajtuarshme e demonëve.

Gëzohu ti, që linde dritën pa tregim; gëzohu ti, që nukë dhe nonjë shpjegim.

Gëzohu ti, që kapërcen dijën e të urtëve; gëzohu ti, që ndriçon mëndjen e besnikëve.

Gëzohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panuseruar.

PRIFTI: Fuqia e të Lartit e hiesoj ahere të pamartuarën për foshnjëlindje, dhe e çfaqë gjirin e saj të mirëpëmëshmë, si një arë gazmore për të gjithë ata, që duan të korin shpëtimin, dyke kënduar kështu: Alilluia.

KORI: Alilluia.

PRIFTI: Dyke patur gjirin hyjpritës, Virgjëresha rendi tek Elisabeta; dhe foshnja e asaj gëzohej, dyke e marrë vesh përshëndoshjen; dhe me këcejtje, si me këndime, i thërriste Virgjëreshës.

Gëzohu, o hardhi me fletë të pafishkura; gëzohu, o arë me pemë të fjeshta.

Gëzohu ti, që lulëzove bujkun njeridashës; gëzohu ti, që mbive mbjellësin e jetës.

Gëzohu, o arë, që solle plotësi mëshirash; gëzohu, o tryezë, që mban lirësinë e ndjesave.

Gëzohu, se lulëzon luadhin e dëfrimit; gëzohu, se gatit limanin e shpirteve.

Gëzohu, o temjan i mirëpritur i nërmjetimit; gëzohu, o ndjesë e tërë botës.

Gëzohu, o mirëdashje e Perëndisë për njerëzit; gëzohu, o kuxim i njerësve përpara Perëndisë.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: Dyke patur përbrënda një shqotë prej mejtimesh të dyshimta, Josefi i urtë u-trubullua, dyke parë ty të pamartuarën, dhe dyke të kujtuar martesë-jedhëse; po kur e mësoj mishërimin prej Shpirtit të Shenjtë, tha: Alilluia.

KORI: Alilluia.

*Pastaj këndohet Kanuni më Tingëllin IV:*

## ANIKSO TO STOMA MU

### KENGA I

Ja gojën e çel tani, i frymësuar prej Shpirtit Shenjt, dhe këngë do t'i këndonj, Nënës së Madhe mi fron, dhe do ta kremtonj, me valle buzëqeshur, me zë do t'i çpall kudo, gjithe çudit' e saj.

Si libër të Zotit Krisht, të hirësuar prej Shpirtit Shenjt, të pa Krye-ëngjëlli, Mari Hyjlindëse, dhe të tha kështu: Lum' ti që sjell gëzimin; mallkimi stërgjyshëror, prej teje tani u-çduk.

Adamin e ngrite lart, o Virgjëreshë Hyjlindëse, dhe Ferrin e shtrin përdhe, o Zonj' e Shenjtë Mari, lum' ti o pallat, i Zotit edhe Mbretit, lum' ti o i zjarri fron, i perandorit Krisht.

Gëzohu o lindëse e të pafishkurit trëndafil, gëzohu se ti po rrit, mollën e erëshme, lul' e qjellshime, e Zotit edhe Mbretit, lum' ti o Hyjlindëse, Zonjë shpëtonjëse.

Thesar i virtutave, që na ke ngritur prej varreve, edhe prej kufomave, Zonjë Hyjlindëse, lule dhe zambak, aromë për besnikët, temjan i mirerëshme, myrr' e paçmuarshme.

### ZBRITESORE I

Ja gojën e çel tani, i frymësuar prej Shpirtit Shenjt. . . .

### KENGA III

O Zonjë dhe Nën' e Perëndisë, burim i pasosur jetësor, ti shiguroji gjith' ata, që të këndojnë plot me zell, dhe lart në qjell ku mbretëron, kurorëzoji me çdo lavdi.

Kallinë qjellor ti na ke mbirë, si arë pa bujë dhe pa lërim, lum' ti alltar i shpirtëshme, ku buk' e jetës na u-vu, lum' ti burim i ujëve, që japin jetë Hyjlindëse.

Mishqerrë që demin na ke lindur, qjellor për besnikët pa cënim, lum' ti o del' e hyjëshme, se qengjin Perëndi na dhe, mëkatin botëror që ngre, gëzohu Zonje nërmjetëse.

Gëzohu mëngjez i ditës sonë, që Diellin solle Jesu Krisht, për botën dritë dhe për ne, dhe errësirë s' le mi dhe, dhe Ferrin e demonëve, e çkatërrove për gjithënje.

Gezohu o derë shpëtimtare ku Fjala dhe Bir, i vetëm shkoj, Ferrit ia theve dyertë, me lindjen e çlironjësit, gëzohu port' e hyjëshme, dhe shpëtimtare e ndriçime.

### ZBRITESORE, III

*O Zonjë dhe Nën' e Perëndisë. . . .*

### SHKURTORJA, T T IV

Përlufteshës gjererale këngët mundëse  
Si përhirim që e shpëtove prej tmerreve,  
Populli yt po të përshkruan, o Virgjëreshë;  
Po sikundër ke fuqi të palëftuarshme  
Prej çfarëdo reziku shpëto-më,  
Se po të thërres: Gëzohu, nuse e panusëruar.

*Pastaj Prfti shkon përpara Korës së Shën Marisë, e temjanis tri herë, dhe këndon Stanzën e Dytë Përshëndoshjeve:*

### STANZA E DYTE

PRIFTI: Barinjtë i dëgjuan Engjëjtë, që e hymonin ardhjen trupërishte të Krishtit; edhe rentnë pranë Bariut, të cilin e gjetnë si një Qënq të pacinuar, të rritur në gjirin e Marisë, të cilën e hymnuan dhe i thanë.

Gëzohu, o Nënë e Qengjit edhe Bariut; gëzohu, o hoborr i dhënve të arësishme.

Gëzohu, o mprojtëse kundër armiqve të padukur; gëzohu, o hapëse e dyerve të Parajsës.

Gëzohu, se qjelli gëzohet me dhenë; gëzohu, se njerëzit këcejnë tok me Engjëjtë.

Gëzohu, o gojë e paheshtur e Engjëjve; gëzohu, o kuxim i pamundur i Athloforëve.

Gëzohu, o themeli e patundur e besës; gëzohu, o shilë e shkëlqyer e hirit.

Gëzohu ti, me anën e së cilës u-çvesh Ferri; gëzohu ti, me anën e së cilës u-veshmë me lavdi.

Gezohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panuseruar.

PRIFTI: Kur e panë yllin hyjrendës, Magët pasuan dritën e tij; dhe me atë kandil e kërkonin mbretin e fortë, dhe kur e arrinë të paarririn, u-gëzuan, edhe thirrë; Alilluia.

KORI: Alilluia.

PRIFTI: Djemat e Khaldenjve e panë në duart e Virgjëreshës atë, që gatoj me dorë njerëzit: edhe e njohë që ishte Zot, megjithëqë kishtë marrë fytyrë robi, dhe rentë që t'i blatojnë dhurata dhe t'i thërresin së bekuarës:

Gëzohu, o Nënë e Yllit të paperënduar; gëzohu, o agim i ditës mistike.

Gëzohu ti, që shove furrën e gënjeshtres; gëzohu ti, që ndriçon dishepujt' e Trinisë.

Gëzohu ti, që e zbritë nga fuqia tiranin çnjerëzor; gëzohu ti, që na çfaqë Krishtin njeridashës.

Gëzohu ti, që na çpërbleve nga feja barbare; gëzohu ti, që na shpëtove nga lloma e mëkatave.

Gëzohu ti, që e pushove adhurimin e zjarrit; gëzohu ti, që e shuan flagën e pasioneve.

Gëzohu, o udhëheqëse e urtë e besnikëve; gëzohu, o dëfrim i gjithë brezave.

Gezohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: Magët u-bënë lëçitës hyjprurës, dhe u-kthyen në Babillonë, dhe ta mbaruan profetinë, dhe të lëçitnë si Krisht për të gjithë, dhe e lanë Herodin si një llafazan, i cili nukë dinte të këndonte: Alilluia.

KORI: Alilluia.

PRIFTI: Shkëlqeve në Egyptë dritën e së vërtetës, dhe dbove errësirën e gënjeshtres; se idhullat e saj u-rrëzuan, se nuk e duruan fuqinë tënde; dhe ata, që shpëtuan prej tyre, i thërresnin Hyjllindëses.

Gëzohu, o lartësim i njerësve, gëzohu, o rrëzim i demonëve.

Gëzohu ti, që shkele arratinë e gënjeshtres; gëzohu, ti, që nxore në shesh prallat e paganizmës.

Gëzohu, o det, që mbyte Faraonin mëndor; gëzohu, o shkëmp, që vadite ata, që kishin etje për jetë.

Gëzohu, o kollonë e zjarrit, që udhëheq ata, që ndodhen në errësirë; gëzohu, o mbulesë e botës, më e gjerë se reja.

Gëzohu, o zëvendëse e ushqimit të mannës; gëzohu, o meshëtare e dëfrimit të shenjtë.

Gëzohu, o dhe i zotimit; gëzohu, o burim i qumështit edhe i mjaltës.

Gezohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: Kur gatitej të largohej nga jeta e tanishme gënjeshtare, Simeoni të priti si foshnjë në pëqi, po të njohu si Perëndi të mbaruar; dhe u-çudit për urtësinë tënde të patreguar, edhe thirri: Alilluia.

KORI: Alilluia.

*Pastaj Vallja e Dytë nis Këngën IV të Kanunit:*

#### KENGA IV

Ti që rri midis lavdisë, përmi fronin e hyjëshmë, nga një re e lehtë, ardhe o Jesu i përjetëshme, dhe na shpëtove me dorën jetëdhënëse, të thërresim pra: Nder dhe lavdi gjithënjë mi ty.

Me këndime dhe me besë, të thërresim Hyllindëse, lum' ti mal i Shenjte, i hiesuar prej Shpirtit Shenjt, lum' ti kandil dhe shtëmbë mannapurëse, që i ëmbëlson, ndjenjat e gjithë besnikëve.

Mëshironjëse e botës, Virgjëreshë Hyllindëse, lum' ti shkall' e shenjtë, që nga dheu shpie në qjell me hir, lum' ti o urë që prior lavdëronjësit, që prej varreve, lart në Parajsën e Engjejve.

Më e lartë prej çdo qjelli, Shpëtimtarin e njerësve, ti në gjin' e shenjtë, e ke mbajtur Zonjë Hyllindëse, lum' ti që ngjeve me gjakun robën ndritëse, dhe shkëlqenjese, të Kumandarit të Forcave.

Ligjëvënësin ke lindur, Virgjëreshë Hyllindëse, që paligjësitë, ua fal të gjithëve darovisht; o lartësi pa kufi o thellësi pa funt, nërmjetonjëse, ti na ke ngritur në qiellin.

Ty që mplekse për njerinë, një kurorë të qjellshime, ty të përhyjnojmë, lum' ti Virgjëreshë Hyllindëse, lum' ti fortesë dhe mprojtje e të gjithëve, o përkrahëse, streh' e përikje e besnikeve.

#### ZBRITESORE IV

Ti që rri midis lavdisë, përmi fronin e hyjëshmë. . . .

#### KENGA V

Të gjith' i habite ti, me një çudi dhe një lavdi: Ti o Virgjëresh' e pamartuar, Zotin e botës që mbretëron lart në qjell, si një bir e mbajte në pëqi, dhe shpëtim që lartazi, u dhurove besnikëve.

O Zonjë Hyllindëse, që linde udhëheqësin, ti na ke shpëtuar nga përmytja, ne mëkatarët dhe të pavyerit, Nus' e Perëndisë Shën Mari, lum' ti o Hyjpritëse, Nën' e Zotit të gjithave.

Kështjella e njerësve, gëzohu o Hyllindëse, vënd' i shenjtërimin dhe lavdisë, vdekja e Ferrit o Nus' e ndriçime, o gëzim i Engjëjve në qjell, lum' ti o përkrahëse, e të gjithë besnikëve.

O fron që shkëlqen dhe ndrit, me Fjalën e përjetëshme, lum' ti o Parajsë shpirtërore, që ke në qëndrë Zotin e jetëve, që i ëmbëlson edhe i ngjall, gjithë të gëzuarit, me kungatën e qjellshime.

Prej teje forcohem, thërresim pra me zë të math: Lum' ti o qytet i Mbretit tonë, e lavdëruar prej gjithë brezave, dhe prej gjithë kishëve kudo, mal i lartë gjer në qjell, det pa funt edhe pa kufi.

Pallat i djamanteve, të çmuar o Hyllindëse, ti që na dhuron margaritarin, Fjalën e Atit dhe Shpëtimtarin Krisht, ti me Perëndinë i pajton, gjithë lumëronjësit, që të lusin besnikërisht.

#### ZBRITESORE V

Të gjith' i habite ti, me një çudi dhe një lavdi.

## KENGA VI

Këtë të kremte e lusim sot, për Zonjën edhe Nënë Hyjlindëse, gjithë hyjmëndësit; eni trokisni pra duartë, dhe lavdëroni Zotin që lindi prej asaj.

Banes' e Fjalës e ndriçime, gëzohu shenjtërim i të gjithëve, Zonjë Hyjlindëse, mburrur prej gjithë Profetëve, prej gjithë Apostujve edhe Shenjtorëve.

Na prure vesën e qjellshime, që shojtë tërë zjarrin pagan të keq: Ty të thërresim pra: Lum' ti qilim i vesëve, që Gjedeoni gjeti Zonjë Hyjlindëse.

Gëzohu Zonjë Hyjlindëse, liman u-bëj për ne lundrëzonjësit, ku të përmblihdemi, brënda në detin e helmeve, dhe të përballim sulmat e të paudhëve.

Gëzohu Zonjë gëzonjëse, mejtimet që të thomi me zë të math: Lum' ti o Hyjlindëse, re edhe ferrë e ndriçime, që ne besnikët pa prerë na mpron na shpëton.

## ZBRITESORET VI

Këtë të kremte e lusim sot, për Zonjën. . . . .

*Pastaj këndohet prej të dy Valleve Shkurtorja "Përlufte-shës Gjenerale "me një mënyre antifonale, të cilën e nis Vallja e Dytë. Pastaj Prifti shkon përpara korës së Shën Marisë, e temjanis tri herë, dhe këndon Stanzën e Tretë të Përshëndoshjeve:*

## STANZA E TRETE

PRIFTI: Kur u-fanes Krijetari, u-çfaq si një krijesë e re midis atyre, që krijoj vetë, se lindi pa atë prej një Nënë Virgjëreshë; dhe dyke parë këtë çudi, e hymnojme dhe thërrisim:

Gëzohu, o lule e paprishjes; gëzohu, o kurorë e e përkorës.

Gëzohu ti, që na ndrite simbolin e ngjalljes; gëzohu ti, që na tregon jetën e Engjëjve.

Gëzohu, o shelk i pemë-ndriçim, prej të cilit ushqehen besnikët; gëzohu, o lis fletë-bukur, prej të cilit mbulohen popujtë.

Gëzohu ti, që linde udhëheqësin për të arratisurit; gëzohu ti, që prure çpërblenjës për robërit.

Gëzohu, o zbutje e Gjykatësit të drejtë; gëzohu, o ndjesë e popullit mëkatar.

Gëzohu, o stoli e bukur e të çveshurve; gëzohu, o dashuri, që kapërcen çdo dëshirë.

Gëzohu, nuse e panusëruar.

KORI. Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: Dyke parë një lindje të çudiçime, le ta harrojmë botën, dhe le të ngjitemi me mëndjen në qjell; se përandaj Perëndia i lartë u-duk mi dhenë si njeri i përunjur, se deshte t'i shpinte lart ata, që i thërresin: Alilluia.

KORI: Alilluia.

PRIFTI: Fjala e papërshkruar ardhi plotërisht mi dhenë, po nuk u-largua asfare nga qjelli, se lindja prej Virgjëreshës u-bë me bashkëzbritje të perëndishme pa nonjë largim prej vëndit, edhe përandaj ajo dëgjonte këto:

Gëzohu, o vënt i Zotit të panxënë; gëzohu, o derë e misterit të shenjtë.

Gëzohu, o lajmë e dyshimtë për të pabesët; gëzohu, o mburrje e padyshimtë e besnikëve.

Gëzohu, o qere e tërëshenjtë e Kerubimeve; gëzohu, o banesë e shkëlqyer e Serafimeve.

Gëzohu ti, që bashkove të kundërtat; gëzohu ti, që pajtave virgjërinë dhe lindjen.

Gëzohu ti, me anën e së cilës u-fal mëkati; gëzohu ti, me anën e së cilës u-çel Parajsja.

Gëzohu, o hapës i mbretërisë së Krishtit; gëzohu, o shpresë e të mirave të ameshuara.

Gëzohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: E tërë krijesa e Engjëjve u-çudit për veprën e madhe të njerëzimit; se e panë Perëndinë e paafëruar si njeri, i cili u-afrua në të gjithë, dhe rrojti bashkë me ne, edhe dëgjoj prej të gjithëve: Alilluia.

KORI: Alilluia.

PRIFTI: I shohim oratorët me shumë fjalë që bëhen nemeçë si pishqet për lindjen tënde, o Hyjlindëse; se nukë dinë të na thonë se qysh ke mbetur Virgjëreshë dhe ke lindur një foshnjë; po ne çuditemi për misterin, dhe thërresim me besë:

Gëzohu, o enë e urtë e Perëndisë; gëzohu, o arkë e providencës së tij.

Gëzohu ti, që i tregon të paditur fillosofët; gëzohu ti, që i provon të pazotët mjeshtërit.

Gëzohu ti, që i thyen leqet e Athenianëve; gëzohu ti, që i mbush rjetat e peshkatarëve.

Gëzohu ti, që na nxier jashtë detit të padijës; gëzohu ti, që e ndriçon popullin me dijë.

Gëzohu, o anie e atyre, që duan të shpëtojnë; gëzohu, o liman i lundrëzonjësve të jetës.

Gëzohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: Krijetari i gjithësisë deshi ta shpëtonjë botën, dhe zbriti vetë në botë; ishte bari si Perëndi, po u-duk si njeri për ne; dhe e ftoj njerinë me formë njeriu, dhe dëgjoj si Perëndi: Alilluia.

KORI: Alilluia.

*Pastaj Vallja e Parë nis Këngën VII të Kanunit:*

## KENGA VII.

Nuk u falëshin, krijesave hyjmëndësit, po Krijetarit lart, dhe kërcënimin me zjarr, e shkelnë me trimëri, psallnin me brohori: Zot lavdi më ty, o Perëndi i Atërve, ti je vetëm i bekuar.

O Hyjlindëse, gëzohu fron i shpirtëshme, o vreshtë plot me hardhi, ngarkuar me rush të kuq, t' alltarëve, që shpirtet e besnikëve, i gëzon me gjak të Krishtit.

Ti që linde mjek, shëronjës të besnikëve, Mari Hyjlindëse, o shkop i shentjës mistik, që lulen e qjellshime, ti lulëzon tani, Zonj' e ndriçime, me gas prej teje mbushemi, edhe jetë trashëgojmë.

Asnjë gjuhë s' munt, të të lavdëronjë vlerësisht, ty o Hyjlindëse; nga Serafimet më lart, u-ngrite kur linde ti, Mbretin Jesu Shpëtimtar; pra ati iu-lut, të na shpëtonjë gjithënjë, sa të lusim plot me besë.

Prej gjith' anëve, lumërohesh o Hyjlindëse, me thirrje gjithënjë. Gëzohu o Shën Mari, që mban në

pëqirin tënt, Fjalën dhe Zotin Krisht; pra ati iu-lut, në librën e të gjallëve, të na shkruanjë o Zonjë.

Ty të lutemi, të gjithë dhe përgjunjemi, me gjithë zëmr' e shpirt; dëgjona pra Shën Mari, shpëtona prej helmeve, se po përmbitemi, edhe ruaje, qytetin tënt Hyjlindëse, prej armiqtve të pabesë.

### ZBRITESORE, VII.

Nuk u falëshin, krijesave hyjmëndësit. . . . .

### KENGA VIII

Djemat e dënuar për të djegur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht, si simbol në vjetëri, dhe si vepërim tani, dhe tërë botën po e mbleth për këng' e lavdërim: Hymnojeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni për gjithë jetët.

Fjalën Jesu Krisht në krah' e prite, atë që mban gjithësinë ti e mban në gji, ti me qumësht e ushqen, Zotin dhe ushqenjësin, e dheut dhe të qiellit dhe të këndonjësve: Hymnojeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni përmi të gjithë jetët.

Ferrën e nxoniti Moisiu, dhe lindjen e Virgjëreshës na e mori vesh. Shëmbëlla e djemave, na e çfaqti qartazi: Në mes të zjarrit hidhëshin dhe nukë digjëshin, Hyjlindëse Mari Virgjëreshë; ty pra të hymnojmë përherë dhe për jetë.

Grackat e demonëve na çveshnë, po ti përsëri na veshe me stoli të re, kur na linde Zotin Krisht, edhe të verbuarit, nga hia e mëkatave e panë Diellin, Hyjlindëse banesa e dritës, ty pra të hymnojmë përherë dhe për jetë.

Ngjallen dhe të vdekurit prej teje, se jetën dhe jetëdhënësin e linde ti, flasin gjuhëlidhurit, shohin të verbuarit, shërohen të leprosurit dhe të lënguarit, dhe çduken krejt nga drita demonët, Zonjë Virgjëreshë shpëtim i njerëzisë.

Ti që na dhurove Shpëtimtarin, dhe ti që na lartësove gjer në qiellin, lum' ti o Hyjlindëse, rojtëse shpëtonjëse, se ti i mpron dhe i bekon gjithë këndonjësit: Hymnojeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni përherë dhe për jetë.

### ZBRITESORE, VIII.

Djemat e dënuar për të djegur. . . . .

*Prifti temjanis Alltarin dhe popullin.*

### KENGA, 1X

Gjithë njerëzit, këceni me ngazëllim, tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavdërojeni, Engjëjt' e qjellit eni kremtojeni, këtë të shenjtë panair të Kryezonjës Mari, dhe thërrisni: Ti je më e lumura, Virgjëresh' e kulluar Hyjlindëse.

Çdo besnik thërret: Gëzohu Hyjlindëse, se gjithënjë na jep, gas që nukë ka mbarim, ti pra shpëtona prej gjithë ngasjeve, nga sulmat e barbarëve dhe gjithë plagëve, që na vijnë nga shumic' e fajeve, dhe mëkatave tona të tmerrshime.

Ardhe për ndriçim, për mprojtje dhe për shpëtim, pra të thërresim sot: Lum' o yll pa parëndim, që sjell në botë Jesunë diellin; lum' o dritë, që i shpie njerëzit, në një jetë qjellore që s' ka mbarim.



Eni besërisht, në Kishën e Zotit Krisht, dhe përshëndosheni, Nënë dhe Hyjlindësen: O Virgjëreshë Zonj' e të gjithëve, lum' ti më e bekuara në mes të grave mi dhe, lum' ti lule, myrrën e përbotëshme, ti e prite në gjirin dhe na e dhe.

Lum' ti o pullump, se ti mëshironjësin, na prure përmi dhe, mburrj' e Oshënarëve, edhe kurora e Athloforëve, dhe e Dëshmorëve dhe e Shenjtorëve, zbukurim' i gjithë të Krishterëve, dhe shpëtimi i gjithë besnikëve.

Zot dhe Perëndi, kurse trashëgimin tënt, fal-u besnikeve, ndjesën e mëkatave, dëgjoja lutjet Nënës Hyllindëse, dhe nërmjetimet pa pushim për gjithë njerëzit, dhe shpëtoji, sipas përdëllimit tënt, edhe falna Parajsën e qiellit.

#### ZBRITESORE, IX.

Gjithë njerëzit, këceni me ngazëllim. . . . .

*Pastaj këndohet ngadale me një mënyrë antifonale prej të dy Valleve Shkurtorja, të cilën e nis Vallja e Parë:*

#### SHKURTORJA, T.T.IV

#### TI IPERMAKHO STRATIGO

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse,  
Si përhirim që e shpëtove prej tmerreve,  
Populli yt po të përshkruan, o Virgjëreshë;  
Po sikundër ke fuqi të palëftuarshme,  
Prej çfarëdo reziku shpëto-më,  
Se po të thërres. Gëzohu o nuse e panusëruar.

*Pastaj Prifti shkon përpara korës së Shën Marisë, e temjanis tri herë, dhe këndon Stanzën e Katërtë të Përshëndosheve:*

#### STANZA E KATERTE

Je kështjella e virgjëreshave dhe e atyre, që përikin më ty, o Virgjëreshë Hyjlindëse; se të ka ndërtuar Krijetari i qjellit e dheut, i cili banoj në gjirin tënt, edhe i cili na mësoj të thërresim:

Gëzohu, o kollonë e virgjërisë; gëzohu, o dhuronjëse e mirësisë perëndore.

Gëzohu, se ti i rilinde mëkatarët e trupit; gëzohu, se ti i urtësove sakatët e mendjes.

Gëzohu, se e dërmovë prishësin e mendjeve; gëzohu, se linde mbjellësin e urtësisë.

Gëzohu, o dhomë e martesës mistike; gëzohu, se ti i pajton besnikët me Zotin.

Gëzohu, o rritëse e mirë e virgjëreshave; gëzohu, o zbukuronjëse e zëmrave të shenjta.

Gëzohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: Asnjë lëvdatë nukë barabitet me shumicën e mëshirave të tua; se edhe sikur të të blatojmë aqë këngë sa ka rërë anës detit, o Mbret i Shenjtë, prapë nukë mbarojmë aqë sa të detyrojmë për ato, që na ke dhënë neve që të thërresim: Alilluia.

KORI: Alilluia.

PRIFTI: E shikojmë Virgjëreshën si një llambadhe dritëdhënëse, e cila çfaqet në errësirë; se ajo e ndes

dritën e palëndëshme, dhe i udhëheq të gjithë në dijen e perëndishme, dhe ua ndriçon mëndjen me agimin, dhe nderohet me këto thirrje:

Gëzohu, o reze e diellit mëndor; gëzohu, o shigjetë e dritës së paperënduar.

Gëzohu, o vetëtimë, që i shkëlqen shpirtet; gëzohu, o bumbullimë, që i tmerron armiqtë.

Gëzohu, se linde diellin e shumëdritëshme; gëzohu, se burove lumin e shumëvalëshme.

Gëzohu ti, që pikturon simbolin e fontit; gëzohu ti, që lave njollën e mëkatit.

Gëzohu, o banjë, që spastron ndërgjegjen; gëzohu, o kupë, që gostit ngazëllimin.

Gëzohu, o erë e luleve të Krishtit; gëzohu, o jetë e dëfrimeve mistike.

Gëzohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: Detyrëlarësi i gjithë njerësve deshte t'i falte detyrat e vjetra, dhe u-afrua nën ata, që ishin larguar prej tij, dhe e grisi dorëshkrimin, dhe dëgjoi nga të gjithë: Alilluia.

KORI: Alilluia.

PRIFTI: Këndojmë lindjen tënde, dhe të përhymnojmë të gjithë, si një tempull shpirtëror, o Hyjlindëse; se Zoti, që i përmban të gjitha në dorë, banoj në gjirin tënt, të shenjtëroj, të lavdëroj, dhe na mësoj të të thërresim të gjithë:

Gëzohu, o tendësim i Perëndisë dhe Fjalës; gëzohu, o Shenjtore më e madhe se të gjithë Shenjtorët.

Gëzohu, o arkë, e larë me flori të Shpirtit; gëzohu, o thesar i jetës i paharxhuar.

Gëzohu, o kurorë e çmuar e mbretërve besëmirë; gëzohu, o mburrje e nderuar e priftërinjve shpresëplotë.

Gëzohu, o fortesë e patundur e Kishës; gëzohu, o kështjellë e pazaptuar e mbretërisë.

Gëzohu ti, me anën e së cilës ngrihen tropetë; gëzohu ti, me anën e së cilës rrëzohen armiqtë.

Gëzohu, o shërim i trupit tim; gëzohu, o shpëtim i shpirtit tim.

Gëzohu, nuse e panusëruar.

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

PRIFTI: O Nënë e lavdëruar, që linde Fjalën më të shentjë se të gjithë Shenjtorët (**3 herë**), prit-e këtë blatë, ruajna nga të gjithë reziket, edhe shpëtona nga mundimi i pritmë ne, që të thërresim: Alilluia.

KORI: Alilluia.

*Pastaj Prifti përsërit pjesën e parë nistore të Stanzës I:*

PRIFTI: Engjëlli kryetar u-dërgua prej qjellit. . .

KORI: Gëzohu, nuse e panusëruar.

*Pastaj këndohet Shkurtorja "Përlufteshës Gjenerale" pak më shpejt me një mënyrë antifonale prej të dy Valleve, dyke nisur Vallja e Dytë. Pastaj Shërbesa vazhdon dhe mbaron si në Përshëndoshjet I.*